



NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE PUBLIC HOUSING ENTERPRISE

Adr: Rr. "Xhevdet Doda" nr. 32 - Prishtinë-Kosovë
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 26 pika 4 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Banesore si dhe Nenit 3, 4 dhe 5 të **Rregullores mbi dhënien me qira të pasurive komerciale të Ndërmarrjes Publike Banesore, SH.A. Prishtinë**, Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. Prishtinë shpallë:

FTESË PËR APLIKIM PËR MARRJE TË PRONAVE ME QIRA

Ftoheni që të aplikoni për marrje në shfrytëzim me qira të **lokaleve afariste, depove dhe garazhave** pronë e Ndërmarrjes Publike Banesore, SH.A. Prishtinë. Pronat e poshtëpërmendura u ipen me qira personave juridik, përveç garazhave të cilat mund t'u ipen në shfrytëzim edhe personave fizik.

Pasuritë komerciale të cilat ipen me qira:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi €/m2 (pa TVSH)
1	Lokali 2/6a, rr. "Lidhja e Prizrenit" (Afer tregut të gjelbert)	15.24 m2	7
2	Lokali 2/11, rr. "Lidhja e Prizrenit" (Afer tregut të gjelbert)	17.50 m2	8
3	Lokali 2/14, rr. "Lidhja e Prizrenit" (Afer tregut të gjelbert)	17.28 m2	7
4	Lokali 15/4, rr. "Xhavit Mitrovica" (Afer parkut te qytetit)	13.54 m2	3
5	Lokali 15/10, rr. "Xhavit Mitrovica" (Afer parkut te qytetit)	16.73 m2	3
6	Garazha 15/5, rr. "Xhavit Mitrovica" (Afer parkut te qytetit)	16.73 m2	2
7	Depo 24/2, rr. "Eqrem Qabej" (Afer semaforave kryesor në Prishtinë)	188.00 m2	1.5
8	Lokali 28, rr. "Mbreti Justinian (Përball Katedrales)	29.10 m2	7.5

Përveç çmimit bazë, qiramarrësi do të paguaj TVSH-në, shërbimet e mirëmbajtjes dhe obligimet komunale.

Periudha e Qiradhënies është për 1 vit, me mundësi vazhdimi.

Qiramarrësi është i obliguar që para nënshkrimit të kontratës me qiradhënësin, të bëjë sigurimin e kontratës së qirasë për gjashtë muaj më gjatë se vetë kontrata, në shumë prej tri qirave mujore neto.

Parametrat që do të shërbejnë për përzgjedhjen e aplikuesëve:

1. Lloji i investimit më të volitshëm;
2. Sektori investues;
3. Numri i të punësuarve nga investimi;
4. Plani/ Përshkrimi i Biznesit;
5. Kohëzgjatja e veprimtarisë së biznesit;
6. Vendi i veprimtarisë së biznesit;

Aplikuesi duhet t'i dorëzoi këto dokumenta:

1. Aplikacionin për marrjen e lokaleve me qira (mund ta merrni në hapësirat e NPB-së);
2. Kopjen e certifikatës së regjistrimit të bashkangjitur me informatat e biznesit;
3. Kopjen e certifikatës së TVSH-së nëse është deklarues i TVSH-së;
4. Kopjen e certifikatës Fiskale;
5. Numrin e xhirollogarisë bankare të biznesit;
6. Plani/ Përshkrimi i Biznesit;
7. Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit;
8. Vërtetimin që nuk është nën hetime;
9. Vërtetimin nga ATK-ja për pagesën e obligimeve tatimore;
10. Fletëpagesën për aplikim.

Aplikacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur. Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: emri i aplikuesit, nr. intern i patundshmërisë dhe kontaktet e aplikuesit (emaili dhe nr. i telefonit).

Tarifa e aplikimit: 10 € (Euro). Kont: BPB: 130 000 150 000 886 4

Aplikacionet nuk do të merren parasysh nëse:

- Aplikuesi tashmë e ka një lokal me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore SH.A.Prishtinë;
- Aplikuesi ka pasur lokal me qira nga Ndërmarrja Publike Banesore dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes;
- Nëse aplikohet për bizneset veprimtaria e të cilave është e ndaluar me ligj në hapësirat përkatëse;
- Nëse aplikacioni nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
- Nëse aplikacioni arrinë pas datës së skadimit të afatit të publikimit të shpalljes.

Personat të cilët duan t'i vizitojnë lokalet me praninë e zyrtarëve të NPB-së, si dhe të kenë qasje në hapësirat e brendshme të tyre, këtë mund ta bëjnë me datën dhe orarin si në vijim:

Numri i lokalit(sipas renditjes ne tabelë)	Data	Periudha kohore
1, 2, 3	19.11.2019	09:00 – 15:00
4, 5, 6	20.11.2019	09:00 – 15:00
7, 8	21.11.2019	09:00 – 15:00

Afati për aplikim është i hapur nga data 13.11.2019 deri më date 27.11.2019

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: Ndërmarrja Publike Banesore-SH.A. në Prishtinë, rruga “Xhevdet Doda” nr. 32, Prishtinë.